



## **NUSEJBA BINT KA'B - UMM AMMARE**

*dielli.net*©

Rreshtat në vijim ia kushtoj një gruaje të veçantë të *ummetit* të Muhammedit (s). Jo, jo vetëm një gruaje... Ajo s'është një grua e rëndomtë, e as vetëm besimtare. Ajo është luftëtare mbi luftëtarët. Ajo është fortesë e fesë së Allahut të cilën armiqtë asnjëherë nuk mundën të lëkundin e ku më ta rrëzojnë. Ajo shndrit ndër emrat e luftëtarëve muslimanë me dritën e yllit ndriçues mes yjesh të tjera.

Është ajo e cila me vullnetin e saj të çeliktë arriti shkallën e shoqëruesit të Pejgamberit (s) në Parajsë. Ajo është ensarijania<sup>1</sup>. Nusejba bint Ka'b bint 'Amr el-Madhiniye, në historinë islame e njohur me nofkën Ummu Ammare.

Kësaj gruaje, shumë të kujdesshme dhe me qëndrim të vendosur, Allahu i Madhërishëm ia zgjeroi kraharorin për fenë e Tij. E zgjodhi të pranonte detyrën e rëndë dhe plot përgjegjësi të përhapjes së vërtetës të Allahut (S.v.T) – *dinit* Islam, duke i dhuruar sakaq shijen e kënaqësisë së shpërblimit të Zotit Fuqiplotë. Ndërsa detyra e përhapjes së fesë së Allahut për të nuk përbente obligim.<sup>2</sup> Kjo ishte besë në emër të Allahut, besë në durim dhe qëndrueshmëri mbi sprovat me të cilat thirrësi (*daiu*) i Allahut ballafaqohet çdo ditë. E me ç'sprova të llojllojshme ballafaqoheshin bartësit e parë të këtij nderimi, ithtarët e parë të Kur'anit dhe traditës (*sunnetit*) në mes të cilave ishte edhe Nusejba (r.a)?

Nuk ka fjalë me të cilat mund të përshkruhet trimëria dhe flijimi i shërbëtores së Allahut Ummu Ammare, flijim para së cilës njeriu admiron me dhimbje të vrullshme në shpirt. Me vrull në shpirt pasi veprat madhështore të kësaj besimtareje janë të paarritura. Na mbetet vetëm admirimi...

Në betejën e Uhudit ishte mes atyre të cilët në çastet e fundit mblodhën shkëndijat e fundit të fuqisë dhe me vendosmërinë e trupat e tyre mbrojtën Pejgamberin e Allahut (s) kur muslimanët u rrethuan nga idhujtarët. La punën e përkujdesjes së të plagosurve, të cilën e bënte më një grup besimtaresh dhe nxori shpatën e me vringëllimën e saj largonte idhujtarët nga Pejgamberi (s). Pastaj i Dashuri i Allahut (s) tha: "Nuk kthehesha as majtas e as djathtas e të mos shihja Ummu Ammaren si lufton." Djali i saj, dëshmues dhe pjesëmarrës i betejës na rrëfen për një pjesë të saj: "Atë ditë isha i plagosur në anën e majtë. Më goditi njeriu që ishte si një palmë e lartë. Kaloi pranë meje, duke mos e kthyer shikimin, ndërsa gjaku rridhte pa ia ndalë. Kur më pa, i Dërguari i Allahut (s) tha: "Fashoje plagën." Mandej u afrua nëna ime e cila kishte me vete pako të përgatitur për fashimin e plagëve dhe ma fashoi atë. Kur mbaroi me fashimin, ajo tha: "O bir, shko e lufto!" me ç'rast Pejgamberi (s) ia ktheu: "Kush mund të durojë atë që duron ti, Ummu Ammare?!" Pastaj, drejt tyre ia behu një njeri dhe e goditi djalin e Nusejbes, ndërsa Pejgamberi i tha: "Ky goditi djalin tënd." Ajo kërceu trimërisht dhe e goditi atë në gju dhe ky u gjunjzua. Pastaj vërejt Pejgamberin se si qeshi aq sa iu dukën cepat e dhëmbëve, e ai përsëri iu drejtua me fjalët: "E more hakun Ummu Ammare!" Por Ummu Ammare edhe vet u plagos e u gjunjzua. Kur e pa, Pejgamberi (s) thirri djalin e saj duke

<sup>1</sup> Ensarët (ar. – ndihmësit) ishin medinasit të cilët e mirëpritën Muhammedin s.a. në ditët më të vështira të dëbimit nga Mekka dhe më pas pranuan Islamin.

<sup>2</sup> Në jurisprudencën islame gruaja nuk e ka obligim të marrë pjesë në luftëra apo përhapjen e fesë.

e drejtuar nga nëna me fjalët: “Nëna jote, nëna jote... fashoja plagën! Allahu ju bekoftë! Vendi i nënës tënde është më i mirë se sa i filan njeriut...” Ndërsa Ummu Ammare, ajo mu’mine.<sup>3</sup> trime e gjithmonë mendjemprehtë kur i dëgjoj fjalët e Pejgamberit (s) u përgjigj: “Ja Resulallah, lutju Zotit që të bëhemi shoqëruesit tuaj në Parajsë.” Pastaj Pejgamberi i bëri dua Allahut (S.v.T).<sup>4</sup>: “O Allah, bëji ato shoqërues të mij në Xhennet.” Kësaj Ummu Ammare me kënaqësi i shtoi: “Vërtet, tani s’më intereson se ç’do më gjejë në këtë dynja.”

Ummu Ammare në betejën e Uhudit mori dymbëdhjetë plagë, të cilat ishin nga shpimi i shtizës dhe goditjet e shpatës. Kjo *muxhahide*.<sup>5</sup> në beteja të shumta luftonte në rreshtat e parë. Allahu s.v.t. jo vetëm që e shquajti me besim të vendosur por edhe me trimëri e qëndrueshmëri e cila ishte shembull për as’habët.<sup>6</sup> e shumtë. Posaçërisht përmendet rasti i betejës së Hunejnit ku shembulli i saj ngjalli fuqi tek burrat. Kur pa se morali dhe fuqitë tek disa luftëtarë u dobësuan, ajo thirri me zë: “Ç’po ndodh me ju, pse ikni?”, e pastaj kërceu me armën prej hekuri që e kishte bërë vetë dhe e goditi ushtarin armik duke e vrrarë. As’habët u mahnitën nga arritja e kësaj mu’mineje, bashkluftëtareje shembullore të tyre.

Të mrekullon shembulli i kësaj *mu’mineje* në betejën e Jemenit. Në këtë betejë ajo nuk ishte vetëm luftëtare por edhe nënë hakmarrëse. Lakmonte për hakmarrjen e vrasësit të djalit të saj i cili ishte vrrarë duke ia coptuar mishin e tij në copa nga pejgamberi i vetquajtur, gjakatar i Musejleme. Zemra e kësaj nëne ishte plagosur dhe kërkonte hakmarrje. Vërtet, Allahu ia dëgjoji lutjet që ajo i dërgonte. E bëri të jetë dëshmitare e vdekjes së tij. Vahshiu në këtë betejë e shpoi Musejlemen me shtizë ndërsa me shpatë e therri djali i dytë i Ummu Ammares, Abdullahu r.a.. Gjatë kësaj beteje, Ummu Ammare kishte humbur dorën dhe kishte marrë shumë plagë të rënda, por zemra e saj ishte plot me paqe ngase fëmija i saj ishte hakmarrë me vrasjen e Musejlemes së mallkuar.

Ummu Ammare, mu’minia trime e krenare vazhdoi të luftojë deri në fundin e jetës së saj duke u sprovuar rregullisht me sprova të rënda të cilat Allahu (S.v.T) bënte besimtarët t’i shijojnë në dunjallëk ashtu që t’i shpërblente për durimin e tyre në Ahiret.

---

Tekstet e prezentuara domosdoshmërisht nuk përfaqësojnë politikën e redaksisë të Dielli.net!

[dielli@dielli.net](mailto:dielli@dielli.net)

---

<sup>3</sup> Epitet kur’anor për besimtarët dhe besimtare. Stad i lartësimit shpirtëror kah Allahu.

<sup>4</sup> S.V.T. Allahu i Lartësuar dhe i Madhëruar është.

<sup>5</sup> Muxhahid [ar.] – Luftëtar i shenjtë.

<sup>6</sup> As’hab [ar.] – Shok (i Pejgamberit s.a.)